



Thirrje për pjesëmarrje në konferencën ndërkombëtare!

“HORIZONTE TË REJA NË PËRKTHIM DHE INTERPRETIM NË EPOKËN DIGJITALE: SFIDA DHE PERSPEKTIVA”, Tiranë, më 29 maj 2025

Tiranë, më 29 maj 2025

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

në bashkëpunim me Fakultetin e Filologjisë, Universiteti i Prishtinës

Përkthimi dhe interpretimi, parë në shekuj si një veprimtari kryesisht praktike, kanë bërë edhe rrugëtimin e tyre si shkencë, veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Translatologjia është zhvilluar pra, në një disiplinë të pavarur, ndërdisiplinore e që përfshin një mori fushash të ndryshme kërkimore. Edhe me zbehjen e kufijve dhe globalizimin si moto të ditëve të sotme, vëmë re se përkthimi vijon të luajë një rol thelbësor në ekuacionin e komunikimit, si atij të folur ashtu edhe të shkruar. E për ta zgjidhur sa më mirë këtë ekuacion, na ndihmon teknologjia, e cila e lehtëson dhe përmirëson punën, porse ende nuk arrin t'i zëvendësojë tërësisht përkthyesit e interpretët. Në këtë epokë digjitale pra, jo vetëm gjuha, por edhe përkthimi po ndryshon në vijimësi e me shpejtësi. Interneti, mediat sociale dhe përhapja e informacionit kanë ndryshuar edhe mënyrën e konceptimit e të realizimit të përkthimit e interpretimit.

Në këtë frymë është përzgjedhur edhe tema e kësaj konference ndërkombëtare, ndaj ftohen të interesuarit, studiues dhe praktikues nga fusha të ndryshme që ndërthuren me përkthimin dhe interpretimin, të bashkohen me ide dhe kumtesa novatore, për të nxitur kështu diskutime e për të sjellë përfundime të vlefshme e të denja sa i përket të ardhmes së përkthimit e interpretimit.

Konferenca do përfshijë, por nuk do të kufizohet në fushat: përkthim/interpretim, përkthim-(shumë)gjuhësi, përkthim-letërsi, përkthim-kulturë/komunikim, përkthim-metodikë/didaktikë (si e përkthimit ashtu edhe e gjuhës së huaj, të gjitha në një ndërthurje me teknologjinë dhe inteligjencën artificiale.

Marrëdhëniet e përkthimit/interpretimit me teknologjinë dhe inteligjencën artificiale janë sot në qendër, si të formimit të përkthyesve e interpretëve të rinj, ashtu edhe të punës së përkthyesve e interpretëve profesionistë. Përfshirja e mjeteve të përkthimit të asistuar nga kompjuteri, përkthimi automatik, teknikat e post-redaktimit, korpuset, mjetet elektronike si fjalorët, bazat e të dhënave online ose mjetet e përpunimit të tekstit, ndikimi i inteligjencës artificiale dhe përkthimit automatik në cilësinë dhe besnikërinë e përkthimit, si dhe zhvillimet e reja në fushën e



trajtimin automatik të gjuhëve natyrore dhe ndikimi i tyre në përkthim, ofrojnë mundësi të pafundme për diskutim.

Në fushën e vetë translato-logjisë mund të trajtohen çështje teorike e praktike të përkthimit e interpretimit, të etikës e deontologjisë, të formimit të përkthyesve e interpretëve të rinj dhe formimit të kompetencave sipas standardit evropian, të statusit të përkthyesit e interpretit, të sigurimit të cilësisë së përkthimit dhe interpretimit në kuadër të integritit të Shqipërisë në BE, si dhe shumë disiplina të tjera që mund të hedhin dritë mbi procesin kompleks të përkthimit. Porse translato-logjia është bijë e gjuhësisë së krahasuar e në kuadër të ndërthurjes së saj me gjuhësinë një vend të veçantë do të zinin modelet gjuhësore, barasvlerësit, gjuhët e specialitetit e disiplina të tjera të gjuhësisë që ndërthuren me përkthimin/interpretimin.

Shpesh, në nënvetëdije, përkthimin e lidhim me letërsinë e për rrjedhojë edhe me kulturën e komunikimin. Letërsia, e cila sot i ka tejkaluar kufijtë e letërsisë kombëtare në sajë të përkthimit, nga njëra anë, si dhe komunikimi nga ana tjetër, vijnë të na vënë para sfidash, të tilla si: ngritja e urave të komunikimit dhe kapërcimi i hendeqeve kulturore, roli i përkthyesve dhe ndërmjetësve gjuhësorë në ndërtimin e dialogut ndërkulturor, roli i përkthimit në promovimin e letërsisë e trashëgimisë kulturore, analiza e ndikimit të konteksteve kulturore në përkthimin profesional dhe ligjor, ndikimi i teknologjisë në rolin e përkthyesve si ndërmjetës kulturor dhe mbrojtës të nuancave kulturore.

Një nga pikat e fundit, por jo më pak të rëndësishme që rimarrim në këtë konferencë është marrëdhënia e përkthimit me metodikën e didaktikën, jo vetëm në lëndën e përkthimit, ku një rol të rëndësishëm luajnë strategjitë novatore në mësimdhënien e përkthimit e interpretimit, përdorimi i teknologjive digjitale, por edhe në mësimin e gjuhës së huaj, gjatë të cilit përkthimi është rikthyer si metodë për përvetësimin e kompetencave ndërkulturore dhe gjuhësore.

Për regjistrimin tuaj në konferencë ju lutem klikoni linkun:

<https://forms.office.com/e/vPy4kJM7G5>

Data të rëndësishme:

Afati i fundit për dorëzimin e abstrakteve: 16 mars 2025

Paraqitja e Abstraktit: Abstraktet duhet të jenë midis 200-300 fjalë, të përfshijnë 5-6 fjalë kyçe dhe të dorëzohen në dy gjuhë: shqip/anglisht ose anglisht/ dhe në gjuhën e paraqitjes së kumtesës. Për formatin e punimit referojuni [Udhëzimeve \(kliko\)](#).



Njoftimi i pranimit të propozimeve: 15 prill 2025

Dorëzimi i kumtesave për botim: deri në 27 qershor 2025

Gjuhët e konferencës: Shqip, Anglisht, Frëngjisht, Spanjisht, Italisht, Gjermanisht. Pjesëmarrja në konferencë mund të jetë fizikisht ose online.

Tarifa e pjesëmarrjes : 3000 lekë ose 30 euro.

Komiteti Organizativ:

Prof. Asoc.Dr. Anida Kisi – Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

Prof.Asoc.Dr. Adriatik Derjaj - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

Prof. Dr. Milote Sadiku - Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i i Prishtinës

Prof. Ass. Dr. Nerimane Kamberi - Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i i Prishtinës

Dr. Zianide Gruda - Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i i Prishtinës

Prof.Asoc.Dr.Iris Klosi- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

Prof.Asoc.Dr. Fjoralba Dado- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

Dr. Mimoza Puto- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

Dr. Elda Katorri- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

Dr. Erta Spaho- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

Dr. Eneida Mataj- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

Rudina Koromani – Kryetare e Kërkimit Shkencor, FGJH-UT

Ardita Poda – Specialiste e Kërkimit Shkencor, FGJH-UT